VENDIM
Nr.63, datë 17.10.200

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "WONDER POWER" SHA PËR AKTIVITETIN E EKSPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa d të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike ", si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Wonder Power" sh.a. për licencimin në aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë "Wonder Power" sh.a., për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria "Wonder Power" sh.a. brenda afateve të përcaktuara në rregulloren për procedurat e licencimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta